

VENDIM
Nr.291, datë 14.4.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohen personat e renditur në listën “a”, që i bashkëlidhet këtij vendimi “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët dhe organizatën Al-Qaida.

2. Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “b”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët dhe organizatën Al-Qaida.

3. Në fund të shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në listën “c”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, sipas shtesave në lidhje me listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat dhe kompanitë, që kanë lidhje me talibanët dhe organizatën Al-Qaida, si dhe personat, organizatat dhe kompanitë, të cilat rezultojnë si financuese apo që ndihmojnë terroristët dhe organizatat terroriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

- a) Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët
 1. Agha; Jan; Alizai
 2. Khalil; Ahmed; Haqqani
 3. Saleh; Mohammad; Kakar
- b) Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida
 1. Said Jan; Abd Al-Salam
 2. Muhammad; 'Abdallah; Hasan; Abu-Al-Khayr
 3. Fahd; Mohammed; Ahmed Al-Quso
 4. Mohammad; Ilyas; Kashmiri
 5. Hakimullah; Mehsud
 6. Wali; Ur Rehman
- c) Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida
 1. Harakat-Ul Jihad Islami